



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Rr "Abdi Toptani" ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel: 04 22268142; 22268141

Nr. 1571/7 Prot.

Tiranë më 26.09.2017

V E N D I M

Nr. 195, datë 26.09.2017

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ,
filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 1571/1 prot., datë 07.09.2017**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 77 e vijues të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe nenit 35, të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr.17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me disa parregullsi të konstatuara në kryerjen e procedurës disiplinore ndaj punonjësit të Institutit të Mjekësisë Ligjor, *****.

VËREJ SE :

Shkak për fillimin e kësaj procedure është bërë informacioni i sjellë nga nëpunësi ***** , protokolluar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 1571 prot., datë 04.09.2017, përmes të cilit pretendohet se ndaj tij, në shkelje flagrante të ligjit, është marrë masa disiplinore "largim nga shërbimi civil". Në kërkesë është parashtruar se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë, nuk ka respektuar kërkesat e ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore të dala për zbatim të tij. Ky Komision Disiplinor nuk legjitimohet të shqyrtojë shkeljen disiplinore të pretenduar, pasi anëtarët e këtij komisioni nuk janë përzgjedhur sipas kërkesave të Vendimit nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil".

Pas analizës së informacionit dhe dokumentacionit bashkëlidhur tij, lindën dyshime të arsyeshme për mundësinë e cenimit të të drejtave të nëpunësit civil, të cilat garantohen nga ligji për nëpunësin civil.

Për kryerjen e plotë të këtij hetimi administrativ, fillimisht janë njoftuar për nisjen e verifikimit të informacionit, subjektet që marrin pjesë në proces, e konkretisht, me shkresat nr. 1571/2/3/4 prot., të datës 04.09.2017, janë njoftuar respektivisht, komisioni disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë, Departamenti i Administratës Publike, si dhe kërkuesi ***** , duke iu kërkuar të vënë në

dispozicion të Komisionerit, të gjitha aktet administrative që materializojnë zhvillimin e procedurës disiplinore në fjalë, që nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore, vënies në dijeni me shkrim të personit që pretendohet se ka kryer shkeljen, deri në dhënien e vendimit përfundimtar prej organit disiplinor.

Aktet që kanë shërbyer për verifikimin e këtij rasti, janë të natyrës si më poshtë:

- Shkresa për fillimin e ecurisë disiplinore, si dhe konfirmimi i marrjes dijeni nga nëpunësi në procedim;
- Urdhri për ngritjen e komisionit disiplinor;
- Materialet në lidhje me shkeljen disiplinore të pretenduar, të cilat kanë shërbyer për fillimin e ecurisë disiplinore;
- Procesverbalet e seancave dëgjimore të nënshkruara nga të gjithë pjesëmarrësit.
- Vendimi i marrë nga komisioni disiplinor.
- Çdo dokument i ndodhur në dosje, si dhe çdo dokumentacion tjetër që është vlerësuar si i nevojshëm për hetimin administrativ.

Pas mbledhjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit, rezultoi se kërkuesi ***** me aktin 1257 prot., datë 03.12.2007, është emëruar në pozicionin e punës “*ekspert-mjeko ligjor*” pranë Instituti të Mjekësisë Ligjore. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar dhe përfshirjen e IML në fushën e shërbimit civil, për këtë nëpunës, referuar nenit 67, të ligjit, me aktin nr. 2158/14 prot., datë 15.08.2014, është bërë deklarimi i statusit të punësimit në kategorinë “*nëpunës civil*”.

Nëpërmjet aktit nr. 4437/8 prot, datë 28.07.2017, nëpunësi ***** është njoftuar se ndaj tij ka filluar një procedurë disiplinore me motivacion “*...keqinformim i titullarit të institucionit, shkelje e rregullave të etikës referuar germës “a” dhe “c”, të pikës 1, të nenit 3, të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, si dhe mospërbushjen e detyrave funksionale referuar aktit nr. 4052/1prot, datë 20.06.2017, “Raport për ushtrimin e kontrollit në Institutin e Mjekësisë Ligjore”, sa i përket pjesës që lidhet me objektin e veprimtarisë së punës si Ekspert-Mjeko Ligjor pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore*”.

Më pas, me aktin administrativ nr. 4437/10, datë 02.08.2017, të Ministrit të Drejtësisë, është urdhëruar ngritja e komisionit disiplinor, për të shqyrtuar rastin në fjalë. Nga ana e komisionit të disiplinës, janë mbajtur pesë seanca dëgjimore, të cilat janë materializuar me procesverbalet përkatëse. Në seancën e fundit, me shumicë votash, komisioni disiplinor, ka dalë me një vendim përfundimtar, me nr. 4437/22, datë 16.08.2017, duke vendosur për nëpunësin civil në procedim, marrjen e masës disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”.

Ndër parimet kryesore të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, është edhe garantimi i qëndrueshmërisë në detyrë të nëpunësit civil. Për të siguruar zbatimin e këtij parimi, në rastet kur pretendohet një shkelje administrative/disiplinore, nga ana e nëpunësit civil, duhet të respektohet një procedure e përcaktuar ligjore.

Duke marrë në analizë të gjitha aktet e administruara në dosjen e procedimit disiplinor, konkluzionet e arritura nga Komisioni Disiplinor dhe pretendimet e nëpunësit civil në procedim, rezultojnë se kjo procedurë nuk është respektuar, pasi gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore, nuk janë

zbatuar kërkesat e përcaktuara në aktet ligjore që rregullojnë në mënyrë të detajuar veprimet që duhet të kryhen në këtë rast.

Në këtë përfundim arrihet pasi, vërehen mangësi procedurale që në nisje të procesit disiplinor, të cilat kanë të bëjnë me faktin se nuk rezulton asnjë akt administrativ (*ankesë/rekomandim*), që të plotësoj kërkesat e kreut II, pika 4, të Vendimit nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”*, e cila është baza për të vënë në lëvizje komisionin disiplinor.

Në këto kushte, në këtë procedurë, nuk arrihet të përcaktohet subjekti që ka iniciuar fillimin e saj dhe mbi çfarë akti administrativ është mbështetur komisioni disiplinor për të vendosur fillimin e ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit *****.

Akti nënligjor i përmendur më sipër, si dhe Udhëzimi nr.1, datë 02.04.2014, i Departamentit të Administratës Publike *“Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”*, përcaktojnë disa veprime administrative të cilat duhet të respektohen gjatë zhvillimit të një procedure disiplinore.

Në përmbajtjen e këtyre akteve, specifikohet se komisioni disiplinor, vihet në lëvizje pas ardhjes së një ankese nga një subjekt i përcaktuar shprehimisht në to, në të cilën duhet të jetë identifikuar nëpunësi civil i cili pretendohet se ka kryer shkelje disiplinore, e po kështu edhe veprimi konkret dhe rrethanat e kryerjes së tij.

Me tej, përcaktohet se, pas shqyrtimit të ankesës/rekomandimit nga ana e komisionit disiplinor, nga ky i fundit, merret vendimi për fillimin ose jo të procedurës disiplinore.

Në rast se ky komision vlerëson se është përpara rastit të një shkelje të rëndë ose shumë të rëndë disiplinore, atëherë fillon procedure, duke njoftuar nëpunësin sipas afateve të përcaktuara në aktet nënligjore.

Nëse shkelja e pretenduar, vlerësohet si e lehtë, atëherë aktet i kalojnë për kompetencë eprorit direkt të nëpunësit civil, i cili është kompetent për të shqyrtuar këtë kategori të shkeljes.

Në rastin konkret, kjo procedurë nuk është respektuar, pasi provohet që nëpunësi civil është njoftuar për fillimin e procedurës disiplinore, përpara se të ngrihej komisioni disiplinor, i cili në fakt duhet të vendoste për fillimin, ose jo, të procedimit, ashtu si analizuam më sipër. Në këtë përfundim arrihet për faktin se, njoftimi i nëpunësit është kryer në datën 28.07.2017, ndërsa komisioni disiplinor është krijuar me Urdhrin e datës 02.08.2017, të Ministrit të Drejtësisë.

Po kështu, në procesin e formimit të komisionit disiplinor, rezulton se nuk janë respektuar kërkesat e kreut I, pika 2, të Vendimit nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”*.

Nga procesverbalet e seancave dëgjimore të administruara gjatë shqyrtimit të rastit, vërehet se kjo çështje është ngritur për shqyrtim edhe nga përfaqësuesi i Departamentit të Administratës Publike, i cili është anëtar i këtij komisioni, për shkak të ligjit.

Nga ana e këtij të fundit, është depozituar shkresa e datës 10.08.2017, përmes të cilës është shprehur qëndrimi i tij për formimin e gabuar të komisionit të disiplinës, pasi tre anëtarë të këtij komisioni ishin në kundërshtim me përcaktimet ligjore.

Bëhet fjalë për punonjësit: ***** , me cilësinë e drejtuesit të njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, ku bën pjesë nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore, ***** , me

cilësinë e eprorit direkt dhe ******, me cilësinë e nëpunësit më të vjetër civil të institucionit ku punon nëpunësi në procedim. Në fakt, këta tre punonjës i kryejnë funksionet e tyre pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe nuk janë pjesë e institucionit ku punon ankuesi, që është IML-ja.

Nga përmbajtja e procesverbaleve të seancës dëgjimore, si dhe nga provat e administruara në dosjen e procedimit disiplinor, rezulton se nga ana e komisionit disiplinor, nuk është kryer një hetim i plotë dhe vlerësim i drejtë i pretendimit të ngritur nga përfaqësuesi i Departamentit të Administratës Publike, në lidhje me përbërjen e komisionit disiplinor, duke shkelur në këtë mënyrë parimin e ligjshmërisë, profesionalizmit dhe barazisë në një proces administrativ.

Konstatohet se në disa raste, procesverbalet nuk janë nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit, e konkretisht nga përfaqësuesi i DAP, i cili ka refuzuar nënshkrimin, me argumentin se procesverbalet nuk pasqyrojnë atë ç'ka ka ndodhur në seancën dëgjimore.

Në këtë rast, komisioni disiplinor, me shumicë votash, ka vazhduar procesin duke mos e marrë parasysh pretendimin e ngritur nga përfaqësuesi i DAP-it, që ka të bëjë me diskutimin e kompetencës ligjore të këtij komisioni, duke argumentuar se nëpunësi në procedim ushtronte atributet e Drejtorit të IML, e për këtë arsye, kompetencën për vlerësimin e shkeljes disiplinore e kishte komisioni i ngritur pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Në këtë rast, vlerësojmë se ky argument është në kundërshtim me ligjin, duke u bazuar në përcaktimet ligjore që rregullojnë ecurinë e një procedure administrative.

Fillimisht, organi administrativ të cilit i është drejtuar për shqyrtim procedura, duhet të verifikojë juridiksionin dhe kompetencën e tij ligjore, për trajtimin e saj.

Detyrimi i organit publik për të verifikuar kompetencën ligjore, përcaktohet në nenin 23, të ligjit nr. 44/2015, "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*". Për të verifikuar nëse kishte ose jo kompetencë ligjore për zhvillimin e procedurës disiplinore, nga ana e komisionit disiplinor duhet të ishin marrë në shqyrtim disa çështje, ndër të cilat:

- ✓ duhet të sqarohet se çfarë pozicioni pune mbante në momentin e kryerjes së shkeljes disiplinore nëpunësi civil në procedim;
- ✓ në cilin institucion varësie ishte i punësuar ky nëpunës dhe me çfarë aktesh ligjore rregullohej veprimtaria e këtij institucioni;
- ✓ nëse ky institucion kishte të ngritur pranë tij, një strukturë e cila të kishte legjitimitetin për të zhvilluar procedurën disiplinore.

Konstatohet se këto përcaktime nuk janë marrë parasysh dhe komisioni ka legjitimuar veprimet e tij me arsyetimin se, personi në procedim disiplinor ushtronte atributet e Drejtorit të IML, ç'ka del nga përmbajtja e urdhrit nr. 1290 prot., datë 02.06.2017, të nxjerrë nga ish drejtori i IML, nëpërmjet të cilit, i delegonte të drejtën për ta ushtruar këtë detyrë, në disa rrethana specifike, pasi ndaj tij ishte duke u zhvilluar një ecuri disiplinore.

Nga analiza e aktit nëpërmjet të cilit i ishte deleguar detyra e drejtuesit të IML, nëpunësit ******, konstatohet se në momentin e procedimit disiplinor, kishin rënë kushtet e delegimit, pasi me vendimin nr. 4052/8, datë 28.06.2017, të komisionit disiplinor, drejtuesi i institucionit, punonjësi ******, i cili kishte urdhëruar delegimin e detyrës së tij tek nëpunësi në procedim, nuk ishte më në detyrë, pasi ndaj tij ishte vendosur "*largimi nga shërbimi civil*".

Në kushtet kur, duke filluar nga data 28.06.2017, punonjësi ***** nuk ishte më në detyrë, atëherë akti i delegimit të detyrës, në kuptim të nenit 104, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, kishte përfunduar, pasi nuk mund të delegohen funksione të cilat nuk zotërohen prej deleguesit.

Gjatë hetimit administrative nuk u paraqit asnjë akt tjetër, nëpërmjet të cilit të urdhërohej delegimi, pas largimit nga detyra të drejtuesit të institucionit të IML, nga ndonjë subjekt tjetër ligjor, tek punonjësi *****.

Vihet re se, gjatë gjithë fazave të shqyrtimit të kësaj çështjeje, komisioni disiplinor e ka trajtuar rastin, sikur nëpunësi në procedim kishte funksionin e drejtuesit administrativ të IML, ndërkohë që ky nëpunës ishte i emëruar në përputhje me ligjin, në pozicionin e punës “*ekspert mjeko- ligjor*”. Edhe nëse do të ishte në fuqi akti i delegimit (*sepse siç u shpjegua më sipër në momentin e shqyrtimit të shkëljes disiplinore delegimi kishte përfunduar*), përsëri nëpunësi civil duhej të trajtohej sipas pozicionit të punës që mbante në momentin e kryerjes së shkëljes disiplinore. Delegimi i detyrës është një gjendje e përkohshme, e cila nuk e ndryshon statusin e nëpunësit civil, në kuptim të deklaramentit të statusit të punësimit.

Përcaktimi i gabuar i funksionit që aktualisht mbante nëpunësi në procedim, e ka çuar komisionin disiplinor në trajtimin e një çështjeje, jashtë kompetencave të tij ligjore. Nëpunësi në procedim ishte punonjës i Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe si i tillë, kjo çështje duhej trajtuar nga komisioni disiplinor i këtij institucioni, i cili ishte ngritur me urdhrin nr. 2055 prot., datë 23.12.2014, të titullarit të institucionit.

Neni 18/5, i ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, përcakton qartësisht se, në rastin e institucioneve të mëdha dhe me veprimtari komplekse, strukturat administrative, që kryejnë shërbimet e brendshme mbështetëse, funksionet e menaxhimit financiar, si dhe auditimin e brendshëm, krijohen brenda institucionit dhe i raportojnë drejtpërdrejt drejtorit apo përkatësisht drejtorit të përgjithshëm të institucionit.

Në rastin që po shqyrtojmë, nëpunësi civil është një punonjës i Institutit të Mjekësisë Ligjore, institucion i cili është krijuar dhe funksionon me Vendimin nr 120, datë 27.02.2003, “Për krijimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore” dhe me Urdhrin nr. 21, datë 03.02.2014, të Kryeministrit, “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Institutit të Mjekësisë ligjore”. Në aktin e krijimit të strukturës dhe organikës së këtij institucioni, është parashikuar edhe ngritja e një njësie e cila do të kryente funksionet e “shërbimeve të brendshme”, sipas kuptimit që i jep këtij pozicioni, neni 16, i ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”. Në strukturën e miratuar, është vendosur krijimi i “sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse”, i cili është përgjegjës edhe për menaxhimin e burimeve njerëzore. Të gjitha këto rrethana, e bëjnë të mundur funksionimin e komisionit disiplinor në këtë institucion, i cili tashmë është ngritur nga drejtuesi i tij dhe funksionon në përputhje me ligjin.

Në këto kushte, nëse komisioni disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë, pas pretendimit të ngritur nga përfaqësuesi i Departamentit të Administratës Publike, i cili është i ngarkuar me ligj për të ndjekur zbatimin e procedurave gjatë ecuresë disiplinore, do të kishte marrë në konsideratë rregullimet ligjore të sipërcituara, atëherë do të arrihej në një konkluzion të saktë ligjor dhe në mbështetje të nenit 24, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, duhet të përcillte dokumentacionin brenda dy ditëve pranë organit kompetent, që në këtë rast është komisioni disiplinor i ngritur pranë IML.

Përbërja e komisionit disiplinor është e një rëndësie të veçantë në një procedim disiplinor, pasi çdo anëtar i tij, ka detyra të përcaktuara qartë në udhëzimin nr.1, datë 02.04.2014, “Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecures dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se të gjitha aktet administrative që materializojnë veprimet që janë kryer për marrjen e masës disiplinore në këtë rast, duke filluar me aktin e njoftimit të fillimit të ecures disiplinore, para krijimit të komisionit disiplinor, duke përfshirë edhe vendimin e largimit nga shërbimi civil, për punonjësin *****, janë akte absolutisht të pavlefshme, në vështrim të nenit 108, nëntitulli “Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm”, të Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet shprehimisht se:

“Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme:

a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me:

i) kompetencën e organit publik;

ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ...”.

Për të rregulluar ligjshmërinë e administrimit të shërbimit civil në këtë rast, subjekti qëka nxjerrë aktet administrative absolutisht të pavlefshme, në këtë rast komisioni disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë, duhet që menjëherë të konstatojë pavlefshmërinë absolute të tyre dhe të rregullojë pasojat që kanë ardhur prej zbatimit të tyre, duke pasur parasysh përcaktimet e nenit 110, dhe 111 të Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet shprehimisht se:

Neni 110

“Pasojat dhe konstatimi i pavlefshmërisë absolute”

“1. Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston.

2. Pavlefshmëria absolute e aktit mund të konstatohet në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, të çdo të interesuari, nga organi publik që e ka nxjerrë atë, organi epror i tij apo organi që është kompetent të shqyrtojë mjetet ligjore administrative, si dhe nga gjykata kompetente për çështjet administrative, sipas ligjit”.

Neni 111

“Konstatimi i detyrueshëm i aktit absolutisht të pavlefshëm”

“Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi”.

Mos zbatimi i procedurave ligjore, në rastet kur pretendohen shkelje disiplinore, cenon garancitë ligjore të zbatimit të parimeve të administrimit të shërbimit civil, për të siguruar qëndrueshmërinë e administratës publike në tërësi dhe të nëpunësit civil në veçanti, si pjesë e saj, si dhe vazhdimësinë e shërbimit civil, të parashikuar në mënyrë të shprehur në nenin 5, kreu II, në titullin “Administrimi i shërbimit civil”, të ligjit për nëpunësin civil.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në nenin 35, të

Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A

1. Të kërkoj nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë menjëherë, si akt administrativ absolutisht të pavlefshëm, aktin nr. 4437/8 prot, datë 28.07.2017, “Njoftim për fillimin e ecurisë disiplinore”.
2. Të kërkoj nga Komisioni i Disiplinës pranë Ministrisë së Drejtësisë, që me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë menjëherë, si akt administrativ absolutisht të pavlefshëm, Vendimin përfundimtar nr. 4437/22, datë 16.08.2017, për marrjen e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, për punonjësin *****.
3. Të kërkojë nga Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore, të rikthejë në detyrën e mëparshme punonjësin *****, duke i paguar pagën me të gjitha komponentët e saj, që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies financiare në datën 16.08.2017, deri në ekzekutimin e këtij vendimi.
4. Të njoftohen për këtë vendim, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë; Komisioni i Disiplinës pranë Ministrisë së Drejtësisë; Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore; Departamenti i Administratës Publike, si dhe ankuesi *****.
5. Për kryerjen e detyrave të përcaktuara më sipër, institucionit i lihet afat, **3** ditë duke filluar ky afat nga dita e nesërme e marrjes dijeni për këtë vendim.
6. Me kalimin e këtij afati, duhet të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mënyrën e zbatimit të vendimit.
7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA